

V E N D I M
Nr.507, datë 18.7.2003

**PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET QË I SHKAKTOHEN
PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHTETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE
TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 63 pika 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 24 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8993, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit kur transferohet, komandohet ose emërohet për herë të parë, për nevoja pune e shërbimi, në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe në komisariatet e policisë jashtë vendbanimit të vet, përfiton shpërblim mujor deri në ndryshimin e vendbanimit, në masën si më poshtë vijon:

a) Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Kukës dhe në komisariatet e policisë së Kukësit, Tropojës, Hasit dhe Pukës, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

b) Në drejtoritë e policisë së qarqeve Shkodër e Dibrë dhe në komisariatet e policisë së Shkodrës, Dibrës, Bulqizës, Matit, Malësisë së Madhe dhe Mirditës, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

c) Në drejtoritë e policisë së qarqeve dhe në komisariatet e tjera të policisë, në masën 5 000 (pesëmijë) lekë.

2. Punonjësit të policisë, që transferohen për nevoja pune, në rastet e pamundësisë së punësimit të bashkëshortes/it, që më parë ka qenë në marrëdhënie pune, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 muaj deri në 1 vit;

b) 100 për qind të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 vit deri në 10 vjet;

c) 100 për qind të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indekssohet me rritjen e pagave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të policisë deri në 15 vjet, në rastet kur në vendbanimin përkatës nuk ekzistojnë mundësi punësimi, llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës për efekt pensioni. Kontributi i sigurimeve derdhet nga institucioni dhe përfituesi, sipas skemës së sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë.

Për përfitimin e kësaj pagese bashkëshortja/i duhet të bëjë kërkesë për t’u punësuar dhe të regjistrohet në zyrat e punësimit e të përkrahjes sociale dhe në institucionin ku punon bashkëshorti.

3. Punonjësit të Policisë së Shtetit, për punë cilësore, angazhim e rezultate të larta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit, gatishmërisë, ruajtjes së administrimit të pronës dhe në kryerjen e detyrave e të shërbimeve të veçanta, i jepet shpërblim deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit. Masa e shpërblimit përcaktohet dhe jepet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, deri në 2 (dy) paga mujore në vit dhe me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, deri në 6 (gjashtë) paga mujore në vit.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

5. Vendimi nr.86, datë 12.3.1992 i Këshillit të Ministrave “Për disa të drejta e detyrime të ushtarakëve, të cilat rrjedhin nga ligji “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

6. Ngarkohet Ministria e Rendit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano